
THIRRJE PUBLIKE

PËR ANGAZHIMIN E NJË ZYRE TË AVOKATISË PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE JURIDIKE DHE PËRFAQËSIMIN E PARTISË DEMOKRATIKE TË KOSOVËS

Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, shpall thirrje publike për pranimin e ofertave nga zyrat e avokatisë/avokatët e licencuar, me qëllim të angazhimit për ofrimin e shërbimeve juridike profesionale, këshillimit ligjor dhe përfaqësimit të Partisë Demokratike të Kosovës pranë institucioneve gjyqësore, administrative, kushtetuese, rregullatore dhe institucioneve të tjera publike, sipas nevojave të saj.

Objekti i angazhimit

Objekt i kësaj thirrjeje është angazhimi i një zyre të avokatisë, e cila do të ofrojë shërbime juridike për Partinë Demokratike të Kosovës, përfshirë, por pa u kufizuar në:

- përfaqësimin ligjor pranë gjykatave të Republikës së Kosovës në konteste zgjedhore, në procedura civile, administrative, kushtetuese, penale, kundërvajtëse dhe procedura të tjera sipas autorizimit;
- përgatitjen e padive, përgjigjeve në padi, ankesave, kërkesave, parashtresave, kallëzimeve penale, kërkesave për masa të përkohshme, opinioneve juridike dhe shkresave të tjera procedurale;
- përfaqësimin dhe këshillimin juridik në procedura para organeve administrative, institucioneve publike, komisioneve të pavarura, organeve rregullatore dhe institucioneve të tjera kompetente;
- ofrimin e këshillave juridike lidhur me çështje që ndërlidhen me veprimtarinë politike, institucionale, organizative dhe administrative të Partisë Demokratike të Kosovës;
- përgatitjen dhe shqyrtimin e akteve të brendshme, kontratave, marrëveshjeve, vendimeve, autorizimeve dhe dokumenteve të tjera juridike;
- ofrimin e këshillimit ligjor për çështje që lidhen me zgjedhjet, financimin politik, komunikimin publik, mbrojtjen e reputacionit, marrëdhëniet e punës, si dhe çështje të tjera me interes juridik për Partinë Demokratike të Kosovës.

Kushtet e përgjithshme për aplikim

Të drejtë aplikimi kanë zyrat e avokatisë ose avokatët individualë të licencuar në Republikën e Kosovës, të cilët i plotësojnë kushtet si në vijim:

- të jenë të regjistruar dhe të licencuar pranë Odës së Avokatëve të Kosovës;
- të kenë përvojë profesionale në përfaqësim gjyqësor dhe këshillim juridik;

- të kenë njohuri dhe përvojë të veçantë në të drejtën civile, administrative, kushtetuese, penale, zgjedhore, të punës, tregtare dhe në fushat e tjera relevante për veprimtarinë e një subjekti politik;
- të kenë kapacitete profesionale dhe organizative për ofrimin e shërbimeve juridike në mënyrë të vazhdueshme, efikase dhe brenda afateve ligjore;
- të jenë në gjendje të garantojnë konfidencialitet të plotë lidhur me të gjitha informatat, dokumentet dhe çështjet që u besohen gjatë angazhimit;
- të kenë reputacion profesional, integritet dhe përvojë të dëshmuar në trajtimin e çështjeve juridike me ndjeshmëri institucionale dhe publike.

Dokumentacioni që duhet të dorëzohet

Ofertuesit e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentacionin si në vijim:

- ofertën për ofrimin e shërbimeve juridike;
- CV-në profesionale të avokatit/avokatëve të propozuar;
- kopjen e licencës/certifikatës së lëshuar nga Oda e Avokatëve të Kosovës;
- listën e fushave juridike në të cilat zyra/avokati ka ekspertizë të veçantë;
- deklaratën për ruajtjen e konfidencialitetit;
- të dhëna kontaktuese të plota, përfshirë adresën, numrin e telefonit dhe emailin zyrtar.

Kriteret e vlerësimit

Vlerësimi i ofertave do të bëhet mbi bazën e kriterëve profesionale, organizative dhe financiare, duke përfshirë në veçanti:

- përvojën profesionale dhe ekspertizën në fushat relevante juridike;
- përvojën në përfaqësim pranë gjykatave dhe institucioneve administrative;
- cilësinë e ofertës profesionale dhe qasjen e propozuar për ofrimin e shërbimeve juridike;
- kapacitetin e zyrës së avokatisë për të trajtuar çështje të ndryshme juridike në mënyrë të shpejtë, profesionale dhe të vazhdueshme;
- reputacionin profesional dhe integritetin e ofertuesit;

- disponueshmërinë për ofrimin e shërbimeve juridike sipas nevojave të Partisë Demokratike të Kosovës;
- përshtatshmërinë e ofertës financiare në raport me natyrën, vëllimin dhe cilësinë e shërbimeve të kërkuara.
- Vlera vjetore e shërbimeve nuk mund të tejkalojë vlerën prej 24.000 (njëzet e katër mijë) euro në vit

Partia Demokratike e Kosovës rezervon të drejtën që, pas shqyrtimit të ofertave, të ftojë ofertuesit e përzgjedhur në intervistë ose takim sqarues, me qëllim të vlerësimit më të plotë të kapaciteteve profesionale dhe kushteve të angazhimit.

Afati dhe mënyra e aplikimit

Ofertat duhet të dorëzohen më së largu deri më datë 27 korrik 2026, në ora 16:00, në njërën nga mënyrat si në vijim:

- në formë fizike, në adresën: Partia Demokratike e Kosovës, Bulevardi “Nënë Tereza”, nr. 9, Prishtinë.

Në subjektin e zarfit të aplikimit duhet të shënohet:

“Ofertë për angazhimin e zyrës së avokatisë për ofrimin e shërbimeve juridike për Partinë Demokratike të Kosovës”.

Dispozita përfundimtare

Kjo thirrje nuk e obligon Partinë Demokratike të Kosovës që të lidhë kontratë me cilindo nga ofertuesit, nëse vlerëson se ofertat e pranuar nuk i plotësojnë nevojat, standardet profesionale ose interesin institucional të saj.

Partia Demokratike e Kosovës rezervon të drejtën që të kërkojë sqarime shtesë, dokumente plotësuese, të negociojë kushtet e angazhimit me ofertuesin më të përshtatshëm, si dhe të anulojë ose përsërisë këtë thirrje, nëse një gjë e tillë vlerësohet e nevojshme.

Vetëm ofertuesit që plotësojnë kriteret e kësaj thirrjeje dhe që vlerësohen si më të përshtatshëm mund të kontaktohen për fazat e mëtejshme të procedurës.

Partia Demokratike e Kosovës

Prishtinë, më 10 korrik 2026